

BALZAK – Evgjëni Grande

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Ç'është "Komeia njerëzore" dhe cila është struktura e saj?
Përmendni disa nga romanet që e përbëjnë atë.

Pse korpusi i veprave të Balzakut është titulluar "Komeia njerëzore"?

Si e siguron unitetin e veprës së vet Balzaku?

Pse Balzaku është shkrimtar realist?

Cilat janë teknikat e Balzakut për krijimin e personazheve?

Tipizimi:

Pasioni mbizotërues:

Cila është e përbashkëta e personazheve në korpusin "Komeia njerëzore"?

-shënime-

Si e përfytyron shoqërinë njerëzore Balzaku?

Përshkruani tiparet thelbësore të plakut Grande dhe të Evgjenisë.

Ku qëndron tragjedia në romanin “E. Grande”?

Si përftohet dramaciteti në romanin “E. Grande”?

Ka lidhje midis personazheve dhe mjedisit?

Ku ndryshon Grandeja prej të nipit në përjetimin e situatave?

(Bazohuni në fragmentet e mëposhtme)

-T'i thoshte “të vdiq yt atë”, s'ish asgjë për Grandenë, se është e natyrshme që baballarët të vdesin para fëmijëve, por t'i thoshte “të la në katër rrugët pa një dhjetësh” si trashëgim, i dukej bablokut se në këto fjalë përmbledheshin të gjitha të këqijat e kësaj bote.

-Në çastet më të vështira të jetës zemra jonë lidhet me vendet ku hasim gëzimet ose hidhërimet, prandaj Karli vërente me një sy të veçantë pemëzat e atij kopshti të vogël...etj. këto hollësira skaliteshin thellë në kujtesën e tij dhe gjatë kësaj ore vendimtare lidheshin me zemrën me anë të një kujtese të veçantë që kanë vetëm ndjenjat.

Plaku Grande:

Evgjeni Grande

-shënime-

Kur Grandeja ka për t'i thënë nipit vdekjen e të atit, kërkon një mënyrë të zbutur për këtë të vërtetë të hidhur.
Cila ishte "e vërteta e hidhur" për Grandenë?

Cilat janë të këqijat që e gjejnë të atin e Karlit, sipas Grandesë (në radhën që i vendos ai)? Ç'tregojnë ato për Grandenë?

Komentoni fjalinë e Grandesë:

Të japësh falimentin është çnderimi më i madh ndërmjet të gjitha çnderimeve të tjera.

Si dhe pse dështojnë përpjekjet e Grandesë për t'ja thënë më butë vdekjet e t'et?

Analizoni fjalinë e Grandesë:

Ai të shkatërroi, të la pa një dhjetësh.

Pse Karli është "mistrec" për Grandenë? Ç'i ka bërë?

Gjeni detaje që tregojnë koprracinë e Grandesë.

Gjeni detaje që tregojnë tiraninë e Grandesë.

-shënime-

Për Balzakun në këtë shoqëri nuk ka më rëndësi as prejardhja shoqërore (fisnik, borgjez etj), as kultura, por paraja.

Ilustrojini këtë me figurën e Grandesë.

A është koprracia e Grandesë çështje vetjake?

[Grandeja] ishte i thëthitur nga spekulimi i mrekullueshëm që bëri mbi rentat e shtetit. Ai kishte menduar t'i vendoste të gjitha të ardhurat e tij, derisa të arrinte një rentë dyqind franga. Nga kjo rrodhën të gjitha fatkeqësitë e Evgjenisë.

Duke u mbështetur këtu dhe në atë ç'ndodhi më pas argumentoni mendimin:

- 1. Balzaku nuk godet thjesht Grandenë, por shoqërinë e tërë përmes tij.**
- 2. Pse rrjedhin prej këtij mendimi të plakut fatkeqësitë e Evgjenisë?**

Argumentoni që veprimi i Grandesë (dhuratat Evgjenisë) nuk është kundër natyrës së tij.

Ç'tregon fakti që Grandeja i di saktësisht sa i ka dhënë dhuratë së bijës?

Komentoni fjalinë e Grandesë:

Unë për ty punoj, për lumturinë tënde. Dhe për të qenë i lumtur në këtë botë, duhen para.

-shënime-

Analizoni dhe ilustroni metodat që përdor Grandeja për të shtënë në dorë arin e së bijës. A ka metoda të ndershme dhe jo të ndershme për të arritur qëllimin e tij?

Shpegoni ndryshimin midis dy fjalive:

Evgjenia – Unë nuk e kam më arin tim.

Grandeja – Si? Nuk e ke arin?

Gjatë bisedës zonjës Grande i bie të fikët dhe sëmuret.

Cili është roli i saj në familje? A i kryen ajo detyrat si grua dhe si nënë? Pse?

Si arrin Balzaku ta japë ftohtësinë midis Grandesë dhe të bijës, kur e shohin që s'po merren vesh?

Grandeja u tmerrua kur pa çehren e zbehtë prej të vdekuri të së shoqes.

Pse tmerrohet? E do të shoqen dhe ka frikë mos e humbë?

Komentoni fjalët që Grandeja i thotë së bijës (fshehin ndonjë kontradiktë?):

- Unë për lumturinë tënde punoj.

- Po të mallkoj ty, tët kushëri dhe fëmijët e tu.

Çfarë i jep forcë Evgjenisë të kundërshtojë të atin?

Cilat janë fjalët-kyç, me të cilat ajo mendon se do të mund të mbrohet para të atit? A i merr parasysh ato Grandeja?

-shënime-

Grandeja, nga fundi i jetës së tij, fillon të stërvitë të bijën.
Pse e stërvit?

Ç'tregon për natyrën e Evgjenisë fakti që jeta e saj ishte monotone? Pse për Grandenë nuk ish e tillë?

Cili ishte shkaku i brengës së Evgjenisë dhe pse askush nuk dinte gjë për të?

(Trashëgimtares së pasur as edhe një herë të vetme nuk i kish shkarë qoja rreth mërzitjes së saj. Miqtë i kishin të rrallë.)

Noteri tregonte kujdes dhe interesim të madh ndaj trashëgimtares së pasur. Ai mendonte, se po të mos kthehej Karli, ajo do të martohej pa një pa dy me nipin e tij, kryetarin.

Si e shihnin Evgjeninë të tjerët?

Gjeni momente të tjera kur përshkruhen sytë plakut koprac dhe krahasojini me përshkrimin më poshtë. Bëni komentet e duhura.

Thirri Evgjeninë, megjithëse e kishte pranë, po sytë i qenë veshur dhe nuk e pa dot të gjunjësuar që po derdhte lot mbi dorën e tij të ngrirë.

Grandeja në fund është në gjendje kllapie. A është vazhdimisht ashtu?

Komentoni qëndrimin para kabinetit ku dergjeshin paratë. Cili është padroni dhe cili skllavi?

-shënime-

Tregoni ku duken frikërat e Grandesë. A e ka shijuar ai jetën?

Komentoni momentet e fundit të Grandesë mbështetur sidomos tek fjalitë:

Kur prifti ia afroi kryqin e praruar në buzë për ta puthur, ai shtriu i babëzitur dorën që ta kapë; ky mundim i fundit i kushtoi jetën. (gjeni nënkuptimin e tyre)

- Më jep uratën, baba – iu lut e bija.

- Ma ruaj me kujdes çdo gjë! Do të më japësh hesap atje lart.

Kujt i jep uratën Grandeja në fund? Çfarë është e bija për të? Ç'kuptim ka fjalia e tij e fundit?